

VENDIM
Nr. 56, datë 29.12.2017

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË
UJËSJELLËS-KANALIZIME KORÇË SHA**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura"; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura"; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a.:

a) Për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, për zonën ekzistuese si më poshtë:

Kategoria e klientëve	Tarifa volumetrike		Tarifa fikse
	Furnizim me ujë (lekë/m ³)	Largimi i ujërave të ndotura (lekë/m ³)	(lekë/klient/muaj)
Klientë familjarë	72	42	140
Klientë publikë	117	64	140
Klientë privatë	140	64	140

b) Për shërbimin e furnizimit me ujë për zonat e reja:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Njësitë administrative			
			Mollaj, Bulgarec Qendër	Voskop, Komuna Vithkuq, Bulgarec (të tjerat)	Drenovë	Voskopojë
1	Konsumatorë familjarë	lekë/m ³	38	28	28	28
2	Konsumatorë publikë	lekë/m ³	110	110	110	110
3	Konsumatorë privatë	lekë/m ³	100	100	100	100
4	Tarifë fikse	lekë/muaj/klient	100	100	100	100

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2018 janë si më poshtë:

Treguesit e performancës	Viti 2018
Mbulimi me ujë	93%
Mbulimi me kanalizime	73%
Niveli i matjes	91%
Uji pa të ardhura	25%
Norma e arkëtimit	94%

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjetës-Kanalizime Korçë sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 23.12.2013, “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Korçë”, shfuqizohet.

5. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2018 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Ndriçim Shani